



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 05 dhjetor 2011
Nr. ref.: AGJ. 163/11

AKTGJYKIM

në

Rastin Nr. KI 108/10

Parashtruesi

Fadil Selmanaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të
Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 170/2009, të 25 shtatorit 2009**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Fadil Selmanaj, me vendbanim në Mitrovicë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 170/2009, të 25 shtatorit 2009, i cili i ishte dorëzuar më 18 tetor 2010.
3. Parashtruesi kërkon vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme për shkak të gjoja *“moskomunikimit zyrtar ndërmjet Gjykatës Supreme dhe të paditurit”*, gjë që, sipas parashtruesit, *“lejon hapësirë për të dyshuar se këtu kemi të bëjmë me një manipulim të llojit të vet dhe se si rrjedhojë e kësaj... [ai], si palë e interesuar, [është] dëmtuar materialisht dhe moralisht....”*.
4. Parashtruesi gjithashtu kërkon që Gjykata Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) *“përmes vendimit të vet ta shfuqizojë, anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme A. nr. 170/2009, të 25 shtatorit 2009, ngase edhe ashtu është i mangët sepse është sjellë në mungesë të provave nga i padituri, i cili ka pasur obligim ligjor t'i prezantojë provat dhe faktet në interes ligjor [të parashtruesit].”*
5. Parashtruesi dëshiron ta arrijë realizimin e të drejtave të tij nga kontrata e tij e punës.

Baza juridike

6. Kërkesa është e bazuar në nenin 113 (7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe rregullin 56 (1) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

7. Parashtruesi e parashtrroi kërkesën në Sekretarinë e Gjykatës më 28 tetor 2010.
8. Më 7 dhjetor 2010, Kryetari i Gjykatës e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Enver Hasani dhe Gjyljeta Mushkolaj.
9. Më 11 janar 2011, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës se parashtruesi e ka parashtruar kërkesën e vet dhe ka kërkuar nga Gjykata që ta vlerësonte kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. nr. 170/2009, të 25 shtatorit 2009.
10. Më 24 shkurt 2011, Gjykata kërkoi informata shtesë nga parashtruesi për të konfirmuar nëse ka qenë i njoftuar me padinë e dorëzuar nga komuna e Mitrovicës në të cilën komuna kërkoi anulimin e Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës.
11. Më 2 mars 2011, parashtruesi e njoftoi Gjykatën se ai kurrë nuk e kishte marrë padinë e dorëzuar nga komuna e Mitrovicës, as që kishte qenë i njoftuar për rastin që ishte në procedurë e sipër në Gjykatën Supreme.
12. Më 5 prill 2011, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Gjykatën Supreme për pretendimet e parashtruesit, të cekura më lart, dhe kërkoi nga ajo që të konfirmonte nëse parashtruesi ishte njoftuar për padinë e dorëzuar nga komuna e Mitrovicës dhe nëse kishte qenë i njoftuar për rastin e tij që ishte në procedurë e sipër në Gjykatën Supreme.

13. Më 12 prill 2011, Gjykata Supreme e njoftoi Gjykatën Kushtetuese se shkresat e lëndës së parashtruesit ia kishte dorëzuar Kuvendit Komunal të Mitrovicës më 17 tetor 2010.
14. Më 25 maj 2011, Gjykata e njoftoi Kuvendin Komunal të Mitrovicës për pretendimet e parashtruesit dhe kërkoi t'ia dorëzonte Gjykatës shkresat e lëndës.
15. Më 10 qershor 2011, Prokurori publik komunal i komunës së Mitrovicës ia dërgoi Gjykatës një kopje të padisë së 24 shkurtit 2009 dhe një kopje të aktgjyimit të Gjykatës Supreme.
16. Më 7 korrik 2011, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për pranueshmëri të kërkesës.
17. Gjykata u këshillua më 6 tetor 2011 dhe miratoi këtë aktgjykim.

Faktet e rastit

18. Në vitin 2001, parashtruesi ishte i punësuar në postin e drejtorit të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në kuadër të Kuvendit Komunal të Mitrovicës. Kontrata e tij e punës ishte e vlefshme deri më 9 mars 2008.
19. Më 11 janar 2008, kryetari i komunës së Mitrovicës nxori Vendimin Nr. 01/49, me të cilin i caktonte drejtorët e drejtorive komunale në komunën e Mitrovicës. Megjithatë, parashtruesi nuk ishte riemëruar.
20. Më 10 mars 2008 dhe më 30 prill 2008, parashtruesi ushtroi ankesë në Drejtorinë për Administratë dhe Personel kundër Vendimit Nr. 01/49, por nuk mori asnjë përgjigje për ankesën e tij.
21. Më 2 tetor 2008, parashtruesi ushtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPMK), me anë të së cilës e kontestonte Vendimin Nr. 01/49 dhe propozonte që ankesa e tij të miratohej si e bazuar. Parashtruesi kërkoi, në veçanti, t'i sigurohej vendi i punës që përkonte me përvojën dhe përgatitjet e tij profesionale dhe të respektohej kontrata e tij e punës.
22. Më 10 shkurt 2009, KPMK miratoi Vendimin Nr. 02 (285) 2008, me anë të të cilit konstatoi që ankesa e parashtruesit ishte e bazuar. Më pas, KPMK e obligoi autoritetin punëdhënës që *“në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi, ankuesit t'i mundësojë realizimin e të gjitha të drejtave nga marrëdhënia e punës në përputhje me kontratën e punës, në atë mënyrë që në pamundësi eventuale të kthimit të ankuesit në punët dhe detyrat e punës sipas kontratës së punës, atëherë në përputhje me dispozitën e nenit 11 par. 11.1 të Urdhëresës Administrative Nr. 2003/2 mbi zbatimin e Rregullores Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, ta ricaktojë në një post tjetër në nivelin dhe shkallën e njëjtë të rrogës, në përputhje me përgatitjet dhe aftësitë e tij profesionale”*.
23. Vendimi Nr. 02 (285) 2008 gjithashtu parashikon që drejtori i Drejtorisë për Administratë dhe Personel është përgjegjës për zbatimin e atij vendimi dhe që, në rast të mosveprimit në përputhje me atë vendim, KPMK do ta njoftojë Kuvendin e Kosovës.
24. Përveç kësaj, në pjesën “këshilla juridike” të vendimit të KPMK-së thuhet që vendimi është *“përfundimtar në procedurë administrative dhe kundër tij nuk është e lejuar*

ankesa por i njëjti mund t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në përputhje me ligjin në fuqi”.

25. Më 24 shkurt 2009, komuna e Mitrovicës ushtroi ankesë kundër vendimit të KPMK-së në Gjykatën Supreme, duke pohuar kryesisht që *“drejtorët e drejtorive komunale nuk janë shërbyes civilë dhe gëzojnë statusin e të emëruarve politikë...”*
26. Ndërkaq, më 5 mars 2009, parashtruesi e njoftoi KMPK-në se Vendimi Nr. 02 (285) 2008 nuk ishte zbatuar, prandaj kërkoi që KPMK-ja t'i ndërmernte masat e nevojshme të parapara me ligj për zbatimin e vendimit të sipërpërmendur.
27. Më 25 shtator 2009, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin A. nr. 170/2009 dhe aprovoi padinë e komunës së Mitrovicës. Si rrjedhojë, Vendimi i KPMK-së A Nr. 02 (285) 2008 ishte anuluar.
28. Në atë aktgjykim thuhet që më 20 mars 2009 Gjykata Supreme ka kërkuar nga KPMK-ja që t'i dërgonte shkresat e lëndës dhe përgjigjen në padi. Kjo kërkesë u përsërit më 9 qershor 2009, duke ia tërhequr vërejtjen KPMK-së se nëse nuk dërgohen shkresat e lëndës në afatin e caktuar, Gjykata Supreme do të vendosë pa shkresa të lëndës. Në aktgjykim më tej thuhet që KPMK-ja nuk iu përgjigj kërkesës së dytë të Gjykatës Supreme, nuk i dërgoi shkresat e lëndës dhe nuk paraqiti përgjigje në padi. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme A. nr. 170/2009, i 25 shtatorit 2009, nuk përmban asnjë referencë që parashtruesi ka qenë i përfshirë në ndonjë fazë si palë e interesuar në këtë konflikt administrativ. Përveç kësaj, Gjykata Supreme as nuk e ka njoftuar parashtruesin as nuk ia ka dorëzuar kopjen e aktgjykimin të kontestuar.
29. Parashtruesi tha që rastësisht “dëgjoji” gjatë vizitës së tij në ndërtesën e komunës së Gjykatës Supreme e kishte nxjerrë aktgjykimin. Më pas, parashtruesi kërkoi nga Gjykata Supreme një kopje të Aktgjykimin A. nr. 170/2009.
30. Më 8 tetor 2010, Gjykata Supreme konfirmoi se e kishte *“pranuar parashtruesin tuaj [të parashtruesit] më 04.10.2010 me të cilën kërkoni që t'ju dërgohet një kopje e Aktgjykimin A. nr. 170/2009”*. Gjykata Supreme gjithashtu e njoftoi parashtruesin se ajo *“nuk bën ekspedimin e vendimeve, prandaj ju mund t'i drejtoheni Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (organit të shkallës së parë) për realizimin e të drejtave tuaja”*.
31. Si rrjedhojë, më 18 tetor 2010, parashtruesi shkoi në KPMK dhe pas kërkesës së tij, iu dha një kopje e aktgjykimin të Gjykatës Supreme.
32. Nuk ka asnjë provë që tregon se parashtruesi kishte marrë kopje të padisë së komunës drejtuar Gjykatës Supreme, apo ndonjë njoftim që rasti ishte në procedurë e sipër apo kishte përfunduar në Gjykatën Supreme.

Argumentet e parashtruesit

33. Parashtruesi pretendon që është palë e interesuar në procedurën që ka filluar në Gjykatën Supreme dhe për të cilën ajo ka nxjerrë vendim përfundimtar.
34. Ai pohon që kurrë nuk është njoftuar për ekzistimin e ndonjë faze të procedurës së tillë dhe se rastësisht ka mësuar për vendimin përfundimtar.

35. Duket që parashtruesi konkludon se e drejta e tij për gjykim të drejtë, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, është shkelur me veprimin dhe lëshimin e organeve administrative dhe gjyqësore.

Përgjigja dhe komentet

36. Gjykata nuk ka marrë asnjë përgjigje dhe/apo komente nga Gjykata Supreme apo komuna e Mitrovicës lidhur me pretendimet e parashtruesit

Baza relevante juridike

37. Më 25 shtator 2009, data e aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ishte në fuqi.
38. Neni 16 i Ligjit të vitit 1977 për konfliktet administrative përcakton që, *“personi tretë, të cilit, anulimi i aktit administrativ të kontestuar, do t'i sjellte dëm direkt (personi i interesuar) ka në kontest pozitën e palës”*.
39. Përveç kësaj, neni 27 i Ligjit për konfliktet administrative parashikon obligimin që paditësi t'ia dërgojë edhe palës së interesuar një kopje bashkë me dokumentet përcjellëse të padisë.
40. Së fundi, neni 33 i Ligjit për konfliktet administrative parashikon obligimin që Gjykata t'ia dërgojë një kopje të padisë palës së interesuar.

Pranueshmëria e kërkesës

41. Kriteret për pranueshmëri janë të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
42. Gjykata i referohet nenit 113 (7) të Kushtetutës, i cili thotë:
- “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”*.
43. Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Për atë qëllim, Gjykata merr parasysh që në Vendimin e KPMK-së Nr. 02 (282) 2008 thuhet që, *“vendimi është përfundimtar në procedurë administrative dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa por i njëjti mund t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në përputhje me ligjin në fuqi”* (këshilla ligjore e atij vendimi).
44. Gjykata Kushtetuese vëren që parashtruesi kurrë nuk ka marrë kopje të aktgjykimit nga Gjykata Supreme. Për më tepër, Gjykata Supreme, nëpërmjet letrës së vet të 8 tetorit 2010, nuk ia dërgoi parashtruesit kopjen e aktgjykimit dhe e udhëzoi t'i drejtohej KPMK-së dhe më pas të kërkonte kopje të aktgjykimit. Prandaj, duket që parashtruesi nuk i ka pasur në dispozicion mjetet e parashikuara juridike.
45. Gjykata gjithashtu vëren që Ligji i vitit 1977 mbi konfliktet administrative nuk e parasheh ankesën si rregull.
46. Megjithatë, neni 52 (6) i Ligjit të vitit 1977 mbi konfliktet administrative parasheh që procedura që ka përfunduar me aktgjykim ose vendim mund të përsëritet *“në qoftë se*

personit të interesuar nuk i është dhënë mundësia për të marrë pjesë në konfliktin administrativ”. Neni 53 i të njëjtit Ligj më tej thotë që kërkesa për përsëritjen e procedurës “mund të kërkohej jo më vonë se brenda 30 ditësh nga data kur pala të ketë mësuar për shkakun e përsëritjes”.

47. Gjykata i referohet rastit të vet Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI 41/09, të 27 janarit 2010, në të cilin tha me sa vijon:

“(…) parashtruesve të kërkesës ju kërkohej që të shterin vetëm mjetet juridike, të cilat janë efektive dhe në disponim. Mjetet diskrecionale ose të jashtëzakonshme nuk duhet të shteren, për shembull të kërkohej nga gjykata që të ri-shqyrtoje aktvendimin e saj. (shihni mutatis, mutandis, ECHR, Cinar v. Turkey, no. 28602/95, Vendim i datës 13 nëntor 2003).”

48. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) konsideron që, “kur ligji vendor lejon që gjykimi të mbahet në mungesë të personit “të akuzuar për vepër penale” (...), sapo personi të kuptojë për procedurën, ai duhet të jetë në gjendje ta marrë një vendim të ri për meritat e akuzës nga gjykata që e ka dëgjuar atë.” (Shih Colozza kundër Italisë, 12 shkurt 1985, paragrafi 27, Seria A nr. 89, paragrafi 29.)
49. Nëse ka ndonjë procedurë që lejon një vendim të ri të tillë, ndërgjyqësi duhet, në parim, të përpiqet ta shfrytëzojë atë: leja për të ushtruar ankesë jashtë afatit kohor kundër një aktgjykimi të nxjerrë në mungesë mund të jetë mjet juridik që duhet të shterohet, por, në rrethanat e posaçme të rastit nuk do të ishte efektiv. (Shih Sejdović kundër Italisë [DHM], Nr. 56581/00, paragrafët 43 dhe 47-55, KEDNJ 2006-II.)
50. Gjykata vëren se nuk ka prova që parashtruesi ka qenë i njoftuar për mundësinë e përsëritjes së procedurës në Gjykatën Supreme, apo që ka pasur mundësi të paraqitet në procedurë të re për t'i paraqitur argumentet e veta.
51. Prandaj, Gjykata konsideron që jurisprudenca e sipërpërmendur e GJEDNJ-së zbatohet *mutatis mutandis* për këtë rast në kuptimin që parashtruesi nuk duhet t'i shterë mjetet e jashtëzakonshme juridike që duken të mos jenë efektive.
52. Prandaj, duke marrë parasysh rrethanat e rastit, praktikën gjyqësore të kësaj Gjykate dhe të GJEDNJ-së, Gjykata Kushtetuese konkludon që kërkesa e parashtruesit është e pranueshme.

Vlerësimi i aspekteve kryesore juridike të kërkesës

53. Siç u cek më herët, parashtruesi pohon që aktgjykimi i Gjykatës Supreme ia shkeli të drejtën e tij për gjykim të drejtë, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (Konventa).
54. Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës thotë:

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër

saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

55. Për më tepër, neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] i Kushtetutës përcakton që:

“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

56. Përveç kësaj, neni 6 (1) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut thotë:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht ... nga [një] gjykatë ... e cila do të vendosë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile.”

57. Në anën tjetër, parashtruesi pohon më saktësisht se është palë e interesuar në procedurë dhe që e drejta e tij për gjykim të drejtë është shkelur për shkak të veprimit dhe lëshimit të organeve administrative dhe gjyqësore.

58. GJEDNJ konsideron që ndonëse e drejta për të marrë pjesë në seancë nuk ceket posaçërisht në nenin 6 (1), *“synimi dhe qëllimi i këtij neni, i marrë si tërësi, tregojnë se personi “i akuzuar për veprë penale” ka të drejtë të marrë pjesë në seancë.”* (Shih Colozza kundër Italisë, 12 shkurt 1985, paragrafi 27, Seria A nr. 89.) *“Neni 6 i Konventës, i lexuar si tërësi, garanton të drejtën e të akuzuarit për të marrë pjesë në gjykimin penal që zhvillohet kundër tij. Kjo nënkupton, ndër të tjera, të drejtën jo vetëm për të qenë i pranishëm, por edhe për të dëgjuar dhe për të marrë pjesë në procedurë. Kjo e drejtë përfshihet në vetë nocionin e procedurës akuzatore”.* (Shih Ziliberg kundër Moldavisë, nr. 61821/00, paragrafi 40, 1 shkurt 2005.)

59. Përveç kësaj, neni 6 (1) zbatohet edhe në procedurën civile edhe penale. Edhe pse neni 6 (2) dhe (3) thekson se ai zbatohet në procedurë penale, GJEDNJ konsideron që neni 6, *“i lexuar si tërësi”*, mund të zbatohet edhe në procedurë civile.

60. Gjykata Kushtetuese është e detyruar, me nenin 53 të Kushtetutës, t'i interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë *“në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*

61. Gjykata përsëri vëren që, në këtë rast, procedura ka filluar në Gjykatën Supreme dhe ajo ka nxjerrë vendim përfundimtar pa praninë e parashtruesit në procedurë dhe pa e njoftuar atë për vendimin që e ka nxjerrë.

62. Prandaj, Gjykata Kushtetuese vëren që neni 6 (1) i Konventës Evropiane dhe neni 31 i Kushtetutës zbatohen për rastin e parashtruesit.

63. Në anën tjetër, parashtruesi pohon që mungesa e tij gjatë rrjedhës së procedurës dhe mungesa e njoftimit për vendim të formës së prerë, shkel të drejtën e tij për gjykim të drejtë.

64. E drejta themelore për gjykim të drejtë buron nga e drejta themelore për mbrojtje gjyqësore, e garantuar me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Në të vërtetë, e drejta për gjykim të drejtë është aludim i përgjithshëm për një sërë të drejtash të tjera, kryesisht, i të drejtës për qasje në gjykatë.

65. Gjykata rithekson që garancitë procedurale, të përcaktuara në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, çdokujt ia sigurojnë të drejtën për të parashtruar në gjykatë ankesë që ka të bëjë me të drejtat dhe detyrimet e tij civile; në këtë mënyrë, ajo mishëron edhe “të drejtën në gjykatë”, prej të cilës e drejta e qasjes, pra e drejta për të iniciuar procedurë për çështje civile në gjykatë, përbën vetëm një aspekt. (Shih *Goldër kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i 21 shkurtit 1975, Seria A nr. 18, f. 13-18, paragrafët 28-36.) E drejta e qasjes në gjykatë nuk nënkupton vetëm të drejtën për të iniciuar procedura, por edhe të drejtën për ta marrë “vendimin” e gjykatës në lidhje me kontestin.
66. Në këtë drejtim, GJEDNJ konsideroi që *“ndërgjyqësi duhet të thirret në seancë gjyqësore jo vetëm për ta ditur datën dhe vendin e seancës, por edhe për të pasur kohë të mjaftueshme për ta përgatitur rastin e tij dhe për të qenë i pranishëm në seancë gjyqësore.* (Shih *Gusak kundër Ruisë*, 7 qershor 2011, *Kërkesa nr. 28956/05*, paragrafi 27.)
67. GJEDNJ më tej konsideroi që *“e drejta e ndërgjyqësit për qasje në gjykatë do të ishte iluzore sikur ai/ajo të mos informohej për zhvillimet në procedurë dhe vendimet e gjykatës lidhur me ankesën, posaçërisht nëse vendimet e tilla janë të natyrës së tillë sa që do ta parandalonin shqyrtimin e mëtejme”.* (Shih *Sukhorubchenko kundër Ruisë*, Aktgjykimi i 10 shkurtit 2005, paragrafi 53.)
68. Në rastin në fjalë, KPMK miratoi Vendimin Nr. 02 (285) 2008, me anë të të cilit konstatoi që ankesa e parashtruesit ishte e bazuar dhe e obligoi komunën e Mitrovicës që *“në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi, ankuesit t’i mundësojë realizimin e të gjitha të drejtave nga marrëdhënia e punës në përputhje me kontratën e punës (...)”.*
69. Ndërkohë, komuna e Mitrovicës ushtroi ankesë kundër vendimit të KPMK-së në Gjykatën Supreme. Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin A. nr. 170/2009, me anë të të cilit e aprovoi padinë e komunës së Mitrovicës dhe, si rrjedhojë, e anuloi vendimin e KPMK-së A 02 (285). Parashtruesi pohon se ishte lënë tërësisht anash në të gjitha këto procedura.
70. Në të vërtetë, komuna e Mitrovicës ngriti padi në Gjykatën Supreme në rastin në të cilin parashtruesi tashmë ishte palë. Prandaj, parashtruesi nuk mund të mos ketë fare dijeni për atë padi, kryesisht për shkak se padia ndikon shumë në përcaktimin e të drejtave të tij civile. Ky konkluzion konfirmohet në nenin 16 të Ligjit mbi konfliktet administrative, i cili thotë që, *“personi tretë, të cilit, anulimi i aktit administrativ të kontestuar, do t’i sjellte dëm direkt (personi i interesuar) ka në kontest pozitën e palës”.*
71. Gjithashtu, duhet të thuhet që KPMK, si *“Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil”* (neni 101 (2) i Kushtetutës).
72. Në anën tjetër, *“pushteti gjyqësor (...) siguron qasje të barabartë në gjykata”* dhe *“Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor”* (nenet 102 dhe 103 të Kushtetutës).
73. Shkresat e lëndës të kërkuara nga Gjykata Supreme ishin saktësisht shkresat e të njëjtit rast për të cilin parashtruesi ushtroi ankesë në KPMK kundër Vendimit Nr. 01/49 të komunës së Mitrovicës. Prandaj, parashtruesi dhe komuna e Mitrovicës ishin palë në

këtë procedurë dhe KPMK veprimi si “organ i shkallës së parë”, siç u cek në letrën e Gjykatës Supreme të 8 tetorit 2010.

74. Gjykata konsideron që jurisprudenca e sipërpërmendur e GJEDNJ-së zbatohet *mutatis mutandis* për këtë rast, që parashtruesi është dashur të thirrej në procedurë gjyqësore jo vetëm për të pasur njohuri për ekzistimin e saj, por edhe për t'i parashtruar argumentet dhe provat gjatë rrjedhës së procedurës.
75. Prandaj, duhet të konkludohet që ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA NJËZËRI

- I. E shpall kërkesën të pranueshme;
- II. Konstaton që ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. E shpall të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 170/2009, të 25 shtatorit 2009;
- IV. Ia kthen këtë Aktgjykim për rishqyrtim Gjykatës Supreme në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;
- V. Mbetet fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të zbatimit të atij Urdhri.
- VI. Urdhëron që ky Aktgjykim t'u komunikohet palëve dhe të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- VII. Deklaron që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Almiro Rodrigues



Prof. dr. Enver Hasani

